



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës -Vushtri

Bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, dhe nenin 8.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë, si dhe në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës **01.Nr. 218/16, dt. 27.10.2016**, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë shpall:

K O N K U R S

Për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta:

Komiteti Konsultativ do të përbëhet nga shtatë (7) anëtarë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme sipas lëmisë përkatëse.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave që i ndërmer kryetari i komunës, komitetet e përhershme, apo kuvendi i komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve para kryetarit të komunës dhe kuvendit të komunës.
- Paraqesin propozimet për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
- Paraqesin ide apo propozime për hulumtime të ndryshme.

Mandati:

Mandati i Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta do të jetë katërvjeçar, nga themelimi i tij.

Anëtarët e këtij komiteti nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

Kompensimi:

Për punën e tyre në komitetin konsultativ, anëtarët e këtij komiteti do të kompensohen konform dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë.

Kushtet:

Të drejtë për të marrë pjesë në konkurs për anëtarësim në komitetin konsultativ kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të Komunës së Vushtrrisë, të cilët duhet të jenë ekspertë, përkatësisht njohës të fushave përkatëse. Njohës i asaj fushe apo anëtar i organizatës e cila merret me atë fushëveprimtari.

Përfaqësimi gjinor në komitetin konsultativ duhet të jetë në kuotën e 30 %-shit, duke përfshirë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në proporcion të përfaqësimit të tyre në komunë.

Kandidati për anëtar në komitetin konsultativ duhet të jetë banor i Komunës së Vushtrrisë.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

- Diplomë universitare.
- Dëshmi mbi përvojën e punës nga fushëveprimtaria e ngjashme (është e preferuar).
- Njohja e punës me kompjuter (është e preferuar).

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e Pranimet të Komunës së Vushtrrisë dhe pastaj dorëzohen çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në orën 15:30 po aty. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisni: Kopjen e diplomës, kopjen e letërnjoftimit, ekstraktin e lindjes, dëshmi mbi përvojën e punës, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen brenda afatit ligjor.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit

